

Sigurimi i jetes me kursim PERMBLEDHJE E KUSHTEVE E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT

Kontrata e Sigurimit i jetes me kursim ofrohet per individe apo subjekte.

Paketat e sigurimit te Jetes me Kursim ofrojne Sigurimin e jetes te shoqeruar me nje depozite kursimi me perfitues te siguruarin ose familjaret e tij qe mund te sherbeje si nje perfitim shtese ne periudhen e pensionit, per shkollimin e femijeve etj.

Paketa **“Sot per Neser”** – Sigurim i jetes me elemente kursimi

Perfitimet:

- Mbijetesa : Pas përfundimit të kontratës së sigurimit, perfituesit do të përfitojë shumën e siguar te garantuar; e cila eshte e percaktuar qe ne lidhjen e kontrates se sigurimit.
- Humbja jetes e personit të siguar: Në rast të një humbje jete natyrale apo aksidentale te personit te siguar, perfituesit marrin shumën e siguar te garantuar në mënyrë të menjëhershme.

Paketa **“Kasa per Femije”**- Sigurim i Jetes te prindit/prinderve dhe element kursimi per femijen. Me ane te ketij produkti mund e sigurohet jeta e te dy prinderve ne te njejtën police.

Perfitimet:

Ne rast se sigurohen te dy prinderit njekohesisht:

- Mbijetesa: Femija do të përfitojë shumën e siguar te garantuar ne përfundimit të kontratës së sigurimit, me mbijetesën e prinderve.
- Humbja jetes e personit të siguar: Shuma e siguar e garantuar perfitohet e menjehershme nga femija me humbjen e jetes se njerit nga prinderit ose me humbjen e jetes se te dy prinderve ne varesi te specifikimit ne police.

Paketa **“Karta e Besnikerise”** – Sigurim i jetes dhe depozite kursimi për punonjësin, nderkohe qe kontributet paguhen nga punëdhënësi.

Perfitimet:

- Mbijetesa : Pas përfundimit të kontratës së sigurimit, perfituesit do të përfitojë shumën e siguar te garantuar; e cila eshte e percaktuar qe ne lidhjen e kontrates se sigurimit.
- Humbja jetes e personit të siguar: Në rast të një humbje jete natyrale apo aksidentale te personit te siguar, perfituesit marrin shumën e siguar te garantuar në mënyrë të menjëhershme.

SIGAL Life ofron mundesi te ndryshme per terheqjen e shumes se siguar:

- Ne menyre te menjehershme
- Ne formën e nje te ardhure mujore per nje periudhe te percaktuar nga vete i siguruari.

Në përputhje me përcaktimin në formularin e policës së sigurimit dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të sigurimit, pervec mbulimit te humbjes te jetes mund te ofrohen edhe Sigurim Shtese nga Aksidentet:

- ‘Paaftesi e plote e perhershme nga Aksidentet ’
- ‘Paaftesi e pjesshme e perhershme nga Aksidentet’
- ‘Perfitim ditor per paaftesi te perkoshshme nga Aksidentet’

Ne zbatim te ligjit Nr 52, date 22.05.2014 ”Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit paraqesin si vijon permbjedhjen e kushteve te Sigurimit te jetes me kursim.

Përcaktime të përgjithshme

Sigurues: Shoqëria e Sigurimit me të cilën lidhet një kontratë sigurimi dhe e cila do t'i paguajë Përfituesit përfitimet e përcaktuara në kontratën e sigurimit;

Kërkesë: Paraqitje me shkrim e interesit të kërkuesit në adresë të siguruesit për lidhjen e një kontrate sigurimi;

Kontraktues: Personi fizik ose juridik që lidh Kontratën e Sigurimit me Siguruesin.

I Siguar: Personi fizik jeta e të cilit sigurohet dhe me mbijetesën ose vdekjen e të cilit lidhet pagesa e shumës së Sigurimit për të cilën është rënë dakord.

Përfitues: Personi fizik që përfiton shumën e rënë dakord në kontratë.

Policë e sigurimit: Dokumenti që vërteton lidhjen e kontratës së Sigurimit të jetës;

Prim i Sigurimit: Shuma të cilën i Siguarit/Kontraktuesi është i detyruar t'i paguajë Siguruesit në bazë të kontratës për Sigurimin e jetës;

Periudha e sigurimit: Kohëzgjatja e kontratës së sigurimit;

Periudha e Pagesës së Primit: Periudha gjatë së cilës paguhen primet. Është e përcaktuar në kërkesën për sigurim. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se periudha e sigurimit.

Ngjarja e Sigurimit: Ngjarje e ardhshme, e cila është e pavarur nga vullneti i të Siguarit. Një ngjarje e tillë është vdekja e papritur e të Siguarit brenda periudhës sigurimit apo mbijetesës e këtij të fundit deri në përfundim të periudhës së sigurimit;

Shuma e sigurimit: Shuma e rënë dakord për të cilën lind detyrimi i siguruesit i përcaktuar me kontratën e sigurimit/policën e sigurimit.

Shuma e kapitalizuar: Shuma që Siguruesi do t'i japë të Siguarit, në përfundim të periudhës së sigurimit, në rast se i Siguarit e ndërpret kontratën e sigurimit dhe nuk e tërheq vlerën e primeve të paguara;

Vlera e Primit të Kthyer: Shuma që Siguruesi do t'i kthejë Kontraktuesit/të Siguarit në rast përfundimi të parakohshëm të kontratës së Sigurimit;

Rezerva matematikore: Vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të Siguruesit pasi janë zbritur vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të të Siguarit

PROCEDURAT E KËRKESAVË PËR DËMHPËRBLIM / PËRFITIM

NGJARJA E SIGURIMIT

Përfituesi ose i Siguarit detyrohet që me ndodhjen e rastit të sigurimit të njoftojnë me shkrim Siguruesin brenda 7 ditësh nga dita e ngjarjes.

Prova e dëmtimit/humbjes

Prova me shkrim e dëmtimit / humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga Njoftimi i Dëmtimit/Humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës.

Personi i Siguar ose Policëmbajtësi ose Përfituesi me shpenzimet e tij, do të t'i dorëzojnë Siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato certifikata, informacione dhe të dhëna që Siguruesi do të kërkojë.

Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që, me shpenzimet e tij, t'i kërkojë Personit të Siguar të kryejë kontrolle mjekësore sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmtimshpërblim/përfitim.

PAGESA E DETYRIME TË TJERA

1. Siguruesi gëzon të drejtën që t'i kërkojë Kontraktuesit/të Siguarit të paguajë për të gjitha shërbimet që ky i fundit kërkon në vecanti nga Siguruesi. Pagesa për shërbimet do të jetë një vlerë e përcaktuar nga Siguruesi.

2. Përfituesi/i Siguarit detyrohet të paguajë të gjitha detyrimet e parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi.

Mbrojtja e te dhenave personale

I Siguarit është njohur me deklaratën e privatesisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL Life

UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.A sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (ligji nr. 9887, date 10.03.2008, “për mbrojtjen e të dhënave personale”) si dhe transferimin e të dhënave personale tek te tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne cdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të behet në përputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara në ligjin nr. 9887, date 10.03.2008, “për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nepermjet lidhjes të kontratës, i siguruari autorizon shoqerine e sigurimit që për efekt dhe zbatim të kontratës të sigurimit të marrë dhe/ose të përpunojë të dhëna personale përfshirë ato sensitive nga pale të treta me qëllim përpunimin e tyre.

E drejta e informimit

- i siguruari ka të drejtën të informohet nga siguruasi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të perdoruara nga shoqeria.

- i siguruari dhe/ose policëmbajtesi janë informuar nga siguruasi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguresit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshperblim, rreziqet e mbuluara dhe të perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe cdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

E drejta e të siguruarit për tu ankuar

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se cmojnë se shoqeria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim në adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do të përgjigjet çdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda 15 ditësh nga marrja e kërkesës/ankesës.

NDRYSHIME

Këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit mund të zëvendësohen apo të ndryshohen me miratimin e një aktuari, dhe pas vënies në dijeni të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, ndryshime për të cilat Kontraktuesi/I Siguruari duhet të njoftohet plotësisht e saktësisht jo më vonë se 10 ditë nga këto ndryshime, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

SUBROGIMI

Pagesa e përfitimi do të jetë në varësi të kalimit tek SIGAL Life i të gjitha të drejtave të policëmbajtësit/përfituesit/të siguruarit ndaj çdo pale të tretë përgjegjëse për ngjarjen e sigurimit, dhe asnjë person ose autoritet nuk do të veprojë për të paragjykuar këto të drejta.

Çdo kërkues pagese sipas kësaj police, me kërkesën e SIGAL Life, do të ndërmerren dhe do të lejohet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave ndaj çdo pale të tretë në emër të të Siguarit para dhe/ose pas çdo pagese të kryer nga SIGAL Life.

JURIDIKSIONI DHE MONEDHA

1. Autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të kontratës së sigurimit është Gjykata e Rrethit Tiranë, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe.

2. Monedha për të gjitha veprimet e parashikuara në këtë kontratë është monedha në të cilën përcaktohet dhe llogaritet shuma e sigurimit.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Për çdo rregullim të marrëdhënieve midis Siguruesit, të siguruarit, Kontraktuesit, përfituesit dhe personave të tjere, për të cilët nuk shprehen këto kushte, janë të zbatueshme parashikimet e Kodit Civil.